



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit

P-012

Prishtinë, më 25 mars 2008, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 25 MARS 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Sllobodan Petroviq dhe Eqrem Kryeziu, kurse mungoi Xhezair Murati.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Bojan Stojanoviç dhe Ibrahim Makolli, kurse mungoi Zylfi Merxha.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

Rend të ditës:

1. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më ___ mars 2008,
 - 1.1. Shqyrtimi parë i Projektligjit të produkteve për mbrojtjen e bimëve,
 - 1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,
 - 1.3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Parlamentar ETIETT lidhur me Ligjin për ngrohjen qendrore.
2. Ndarja e kompetencave të anëtarëve të Kryesisë sipas Rregullores së Punës së Kryesisë,
3. Shqyrtimi i nismës së Komisionit Parlamentar ETIETT për hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, ujërave të zeza, dhe të mbeturinave,
4. Të ndryshme.

1. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës. Kryetari propozoi që seanca e radhës të mbahet më 28 mars 2008.

Kryesia vendosi t'ia propozojë Kuvendit këtë

Rend dite

1. Koha për pyetjet parlamentare,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të produkteve për mbrojtjen e bimëve,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Kryetari në vazhdim i informoi të pranishmit se lidhur me pikën 1.3, me të cilin Ministria e Energjisë dhe Minierave, nëpërmjet Qeverisë, kishte kërkuar që Ligji për ngrohje qendrore të tërhiqet nga procedura e shpalljes nga PSSP-ja. ai propozoi që të kërkohet deklarimi i Komisionit funksional të Kuvendit lidhur me kërkesën e Qeverisë, e pastaj të vendoset në seancën plenare.

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e Kryetarit, nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Kërkohet nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që në bashkëveprim me sponsoruesin e Ligjit t'i harmonizojnë qëndrimet dhe rekomandimet divergjente të tyre lidhur me Ligjin për ngrohje qendrore.
2. Komisioni funksional t'i paraqes Rekomandim Kryesisë së Kuvendit lidhur me procedimin e mëtejshëm të këtij ligji.

Mbledhja vazhdoi pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

2. Ndarja e kompetencave të anëtarëve të Kryesisë sipas Rregullores së Punës së Kryesisë

Kryesia vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i nismës së Komisionit Parlamentar ETIETT për hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, ujërave të zeza, dhe të mbeturinave

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë se në bazë të rregullës 33.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport e Telekomunikacionin, ka marrë nismën për hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, ujërave të zeza, dhe të mbeturinave e cila nismë është filluar në Legjislaturë e dytë por nuk është përfunduar.

Kryesia, pas diskutimit të të gjithë anëtarëve të saj, nxori këtë :

P e r f u n d i m

I. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion të përgatitë dhe Kryesisë së Kuvendit t'i paraqet **Informatën** me të dhënat lidhur më:

- a) fazat e procedimit në hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, ujërave të zeza dhe të mbeturinave nga Komisioni i legjislaturës së mëparshme;
- b) specifikimin e kostos së shpenzimeve për hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, ujërave të zeza dhe të mbeturinave dhe
- c) përkufizimin e qartë të bazueshmërisë dhe formës për krijimin e trupit punues për draftimin të këtij Projektligji.

4. Të ndryshme

4.1 Shqyrtimi i ftesës për Komisionin për Punë të Jashtme për ta vizituar Norvegjinë

Xhavit Haliti i informoi anëtarët e Kryesisë se Komisioni për Punë të Jashtme këto ditë ka pranuar një ftesë zyrtare për ta vizituar Norvegjinë nga data 27 deri me 31 mars 2008, me ç'rast janë ftuar Kryetari dhe zëvendëskryetari i këtij komisioni për ta përfaqësuar Kuvendin e Kosovës .

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesë e Komisionit, mori këtë

V e n d i m

1. Anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme: Sabri Hamitit dhe Xhavit Halitit u lejohet udhëtimi zyrtar në Norvegji, prej datës 27 deri më 31 mars 2008.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të deputeteve, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i bartë buxheti i Kuvendit.

4.2 Njoftimi lidhur me Qendrën protokollare të Kuvendit në Villa Gërmia

Kryesia shtyu shqyrtimin e kësaj pikë për një mbledhje të veçantë.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12 : 50.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale